



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:073558

Datë: 31.05.2019

Numri i dokumentit: 00341685

P.nr.81/19

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike - procesmbajtëses Birsën Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarve R.Gj nga ... i akuzuar për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar 3.1 të KP lidhur me nenin 1 të KPK dhe të akuzuarës A.Gj nga ...për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 1 të KP sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2937-1/18 të dt.22.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit të Shtetit Beqë Shala dhe të akuzuarve, me datë 20.05.2019, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.R. GJ, nga i ati E., e ëma K, e lindur K, i lindur me dt..... në ... ku edhe jeton në rr. ..., pa.nr.ka të kryer shkollën e mesme , i pa punë i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. A. GJ., nga i ati E. dhe ëma K., e lindur K., e lindur me datën në, tani me banim nërr."...." pa.nr.ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me letërnjoftim nr.

JANË FAJTOR

I akuzuari R. GJ.

I.Me datë 09.11.2018 në, në rr....., pa nr. saktësisht në kafeteri të qendrës tregtare "...." i pandehuri me dashje i shkakton lëndim trupor të dëmtuarës A.Gj të cilën e ka motër , në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje dhe fjalosje paraprake rreth problemeve pronësore – familjare derisa ishin duke pirë kafe në këtë kafeteri, i pandehuri fillimisht e godet me shuplakë të dëmtuarën duke thënë ""Lapericë, kurvë ti po thu nuk është shtëpia e ime për qet punë të kam thirrë sot" e më pas vazhdon ta godas në pjesë të ndryshme të trupit duke shkaktuar lëndime trupore në formë të ndryshme të dy mollëzave të shkaktuara nga

veprimi mekanik të mjetit të fortë mbretës (jo i mbrehtë) e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar 3.1 lidhur me nenin 1 të KP.

E akuzuara A. Gj

II.Se me datë,vend dhe kohë të njëjtë dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitivin e parë të aktakuzës e pandehura A.Gj me dashje i shkakton lëndim trupor të dëmtuarit R Gj, vëlla i pandehurës në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjes dhe fjalosjes paraprake rreth problemeve pronësore –familjare derisa ishin duke pirë kafe në një kafeteri te , e pasi fillimisht ishte sulmuar nga i pandehuri me shuplakë e pandehura kishte kapur një filxhan të kafes nga tavolina ku ishin duke pirë kafe dhe e kishte goditur të dëmtuarin R. në kokë me çka i ka shkaktuar lëndime trupore në formë të plafeve shquese në kokë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrehtës (jo i mbrehtë) e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale lëndimi lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 1 të KP.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 7, 8, 9, 10, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe të nenit 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 1 të KP të akuzuarit i gjykon dhe ua shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Të akuzuarit **R.GJ** ia vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (**gjashtë**) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej **1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarës **A.Gj** ia vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej **1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit lirohen nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore pasi që janë shfrytëzues të ndihmës sociale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate ka parashtruar Aktakuzë PP/II.nr.2937-1/18 të dt.22.01.2019 , kundër të akuzuarve R.Gj nga i akuzuar për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar 3.1 të KP lidhur me nenin 1 të KPK dhe të akuzuarës A.Gj nga për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 1 të KP .

Gjykata në këtë çështje penale duke vepruar sipas Aktakuzës, ka caktuar shqyrtimin fillestar gjyqësor, ku në shqyrtimin fillestar gjyqësor të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen sipas aktakuzës.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me datë 09.11.2018 në ..., në rr..., pa nr. saktësisht në kafeteri të qendrës tregtare “...” i pandehuri R.Gj me dashje i shkakton lëndim trupor të dëmtuarës A.Gj të cilën e ka motër , në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje dhe fjalosje paraprake rreth problemeve pronësore – familjare derisa ishin duke pirë kafe në këtë kafeteri, i pandehuri fillimisht e godet me shuplakë të dëmtuarën duke thënë “Lapericë, kurvë ti po thu nuk është shtëpia e ime për qet punë të kam thirë sot” e më pas vazhdon ta godas në pjesë të ndryshme të trupit duke shkaktuar lëndime trupore në formë të ndryshjeve të dy mollëzave të shkaktuara nga veprimi mekanik të mjetit të fortë mbretës (jo i mbrehtë) e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet.

Se me datë, vend dhe kohë të njëjtë dhe mënyrë të përshtuar si në dispozitivin e parë të aktakuzës e pandehura A.Gj me dashje i shkakton lëndim trupor të dëmtuarit R. Gj, vëlla i pandehurës në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjes dhe fjalosjes paraprake rreth problemeve pronësore –familjare derisa ishin duke pirë kafe në një kafeteri te ... , e pasi fillimisht ishte sulmuar nga i pandehuri me shuplakë e pandehura kishte kapur një filxhan të kafes nga tavolina ku ishin duke pirë kafe dhe e kishte goditur të dëmtuarin R. në kokë me çka i ka shkaktuar lëndime trupore në formë të plafeve shquese në kokë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrehtës (jo i mbrehtë) e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar gjyqësor vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila u vihet në barrë e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënpar.3.1 lidhur me nenin.1 pika të KP-së, ku për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ua shqiptoi dënimin me kusht secilit në kohëzgjatje me **nga 6 (gjashtë) muaj**

i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor **prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse të akuzuarit nuk kryejnë veprë të re penale.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga të pandehurit, të cilët janë motër e vëlla dhe ju vjen keq që kjo ka ndodhur në mes tyre ka qenë moment i çastit dhe janë penduar për veprimet e tyre, janë persona familjar të cilët i kanë premtuar gjykatës se në të ardhme nuk do të ndodh diçka e ngjashme.

Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarve u shqiptoi sanksionin penal sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksioni shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale juridike të tyre dhe se me këtë sanksion do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 453 par 4. të KPP-së pasi që të akuzuarit janë shfrytëzues të ndihmës sociale sipas kartelës nr.....për R. Xh dhe nr.... për A.Xh dhe se pagesa e shpenzimeve procedurale do të rrezikonte ekzistencën e tyre materiale.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.81/19 datë 20.05.2019

Sekretare Juridike
Birsen Shoshani

Gjyqtarja
Shpresa Emra

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.